




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Telkos
Enver Berisha
Drejtor
Prishtinë

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2021/184 – Telkos (Palë ankuese) kundër Klan Kosova

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03, janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datën 21 prill 2021 ka pranuar një Ankesë nga Pala ankuese me pretendimin se në lajmet qendrore të datës 21 prill 2021 dhe në emisionin e lajmeve dhe aktualiteteve në mbrëmje “Edicioni special” është transmetuar lajm i pavërtetë dhe i njëanshëm, ku thuhet se: *“Operatorit Telkos i ndërpritet sinjali nga tri televizionet duke thënë se nuk ka treguar gatishmëri për marrëveshje me këto televizione, si dhe ka akuzuar që jemi duke bërë pirateri duke transmetuar liga sportive në mënyrë ilegale. Klan Kosova ka shfaqur me fotografi dhe ka shqiptuar me logon e operatorit Telkos dhe ka shtrembëruar lajmin dhe ky lajm neve na ka dëmtuar jashtëzakonisht shumë në dëmtimin e imazhit tek klientët tonë si dhe ka shfaqur pasiguri tek ta. Klan Kosova në lajmet e mbrëmjes nuk ka treguar të vërtetën duke thënë se Telkos nuk ka treguar gatishmëri për marrëveshje.”*
3. KPM me datën 27 prill 2021, përmes një shkrese, e ka njoftuar Klan Kosovën për Ankesën e pranuar nga Pala ankuese dhe ka kërkuar sqarim lidhur me pretendimet e Palës ankuese.
4. KPM, pavarësisht afatit shtesë nuk ka pranuar përgjigje nga Klan Kosova lidhur me kërkesën.
5. KPM ka analizuar Ankesën e Palës ankuese, ka bërë monitorimin dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 19 maj 2021 ka gjetur se Klan Kosova ka transmetuar këtë informacion lidhur me ndërprerjen e sinjalit të disa televizioneve vendore ndaj Palës ankuese duke u bazuar në një njoftim nga televizionet TV Dukagjini, Kanal 10 dhe TE 7.

Analiza ligjore

6. KPM, pretendimet ankimore të Palës ankuese i ka trajtuar në kuptim të nenit 6 paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale.

Neni 6, paragrafi 1 i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

“OSHMA duhet të raportojnë lajme me saktësi dhe t’i paraqesin ato në mënyrë të paanshme. Ata nuk duhet të transmetojnë material për të cilin e dinë ose duhet të dinë së është i pa vërtetë ose mashtrues.”

7. KPM bazuar në Raportin e monitorimit të datës 19 maj 2021 ka gjetur se saktësia e të dhënave të transmetuara nga Klan Kosova nuk mund të vërtetohet dhe se në lidhje me këtë çështje Pala ankuese ka të drejtën të paraqesë dhe t’i kundërshtojë të dhënat e transmetuara nga Klan Kosova, ashtu siç përcaktohet me nenin 10, paragrafin 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“Çdo person, pa dallim shtetësie ose vendbanimi, që përmendet në një ofrues të shërbimit medial për të cilin faktet janë bërë të disponueshme për publikun të cilat ai i deklaroi që janë të pasakta, mund të ushtrojë të drejtën e reagimit për të korrigjuar faktet që shqetësojnë atë person.”

8. KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura gjen se saktësia e të dhënave të transmetuara nga Klan Kosova nuk mund të vërtetohet dhe se Pala ankuese me qëllim të kundërshtimit të këtyre të dhënave, mund të ushtrojë të drejtën e reagimit sipas nenit 10 paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.

Vendimi

9. Pala ankuese ka të drejtë që me qëllim të kundërshtimit të informacionit të transmetuar nga ana e Klan Kosova ta shfrytëzojë të drejtën e reagimit, ashtu siç përcaktohet me nenin 10, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

E drejta për ankesë

10. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

11. Bordi për Ankesa do t’i merr parasysht vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Xhevat LAJFI
Kryetar

26.05.2021
Datë